



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Sinjal" Sh.P.K. të datës 17.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 13.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve rurale" me nr. të prokurimit 616-22-11453-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Sinjal" Sh.P.K. e datës 17.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 13.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve rurale" me nr. të prokurimit 616-22-11453-2-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Sinjal" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "Sinjal" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 17.06.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 13.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve rurale" me nr. të prokurimit 616-22-11453-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: *“Te kërkesat e pershtatshmerise, sipas Aneksit 7. te dosjes se tenderit kerkohet Gjysmë rimorkio elektrike për sigurimin e vend punishtes gjatë realizimit të sinjalizimit. Te dokumentet e dorezuara ne oferten e Operatorit Fitues Select Prima sh.p.k. Ofrohet Rimorkio me shenja dhe drita. Pajisja edhe ne foto e poashtu edhe ne dokumentin, fature nuk paraqitet dokumenti adekuat. Ne baze te kesaj, Autoriteti Kontraktues nuk do te duhej te shperblente OE me kontrate nen kushtet kur i njejt i ka plotesuar te gjitha kërkesat sipas Aneksit 7”*.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 23.06.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

**Lidhur me pretendimet e parashtruesit:** fillimisht duhet theksuar se sipas dosjes së tenderit Aneksi 7 është kërkuar *“Një (1) Gjysmë rimorkio elektrike për sigurimin e vend punishtesh gjatë realizimit të sinjalizimit”*. Nga oferta e tenderuesit të rekomanduar (*“Select Prima” Sh.P.K.*) është gjetur se operatori ekonomik ka dorëzuar dëshmitë e nevojshme se e plotëson këtë kërkesë të dosjes së tenderit dhe atë ka dorëzuar një faturë/kontratë, disa fotografi si dhe një kopje të vërtetuar nga noteri të dokumenteve origjinale me shenjën LRP.Nr.9712/2022. Tutje nga raporti i vlerësimit është gjetur se komisioni vlerësues në këtë rast ka administruar këto dokumente të dorëzuara nga tenderuesi i rekomanduar dhe në kuptim të nenit 59 të LPP ka konstatuar se tenderuesi i rekomanduar bazuar në këto dëshmi dokumentare e plotëson edhe këtë kërkesë të DT. Për më tepër komisioni i vlerësimit me qëllim që të vërtetoj këtë gjendje faktike, ka dalur edhe në terren dhe ka gjetur se tenderuesi i rekomanduar e posedon *“Një (1) Gjysmë rimorkio elektrike për sigurimin e vend punishtesh gjatë realizimit të sinjalizimit”* saktësisht siç është kërkuar me DT. Pra nuk ekziston asnjë dilemë që tenderuesi i rekomanduar nuk e ka dëshmuar se e posedon pajisjen e kërkuar sipas DT.

Sa i përket fotografive që parashtruesi i ka dorëzuar së bashku me kërkesën për rishqyrtim, pikërisht nga këto fotografi vërehet se fjala është për gjysëmrimorkio sikurse është kërkuar me DT dhe jo me rimorkio sikurse pretendon parashtruesi. Nuk është aspak relevante se çfarë titulli u është vendosur këto fotografive përderisa pajisja për të cilën bëhet fjalë është pikërisht ajo që është kërkuar sipas dosjes së tenderit.

Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 23.06.2023



Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.